







NORMAT E INTERESIT PER DEPOZITAT PER KLIENTET JO-INDIVIDE (%) BAZE VJETORE
DEPOSIT INTEREST RATES FOR NON INDIVIDUAL CUSTOMERS (%) ANNUAL BASIS

1 Nëntor 2016 / November 1st, 2016

NORMAT E INTERESITIT PER DEPOZITAT PER KLIENTET JO-INDIVIDE (%) BAZE VJETORE
DEPOSIT INTEREST RATES FOR NON INDIVIDUAL CUSTOMERS (%) ANNUAL BASIS

Depozite me afat/Time Deposits						
LEK 	1M	3M	6M	1Y	2Y	
≤19,999,999	0.40	0.40	0.45	0.60	1.15	
20,000,000-49,999,999	0.45	0.45	0.50	0.65	1.20	
50,000,000-99,999,999	0.50	0.50	0.60	0.70	1.25	
≥100,000,000	neg	neg	neg	neg	neg	
EUR 	1M	3M	6M	1Y	2Y	
≤199,999	0.002	0.002	0.005	0.005	0.02	
200,000-499,999	0.002	0.002	0.005	0.005	0.05	
500,000-999,999	0.002	0.002	0.005	0.010	0.05	
≥1,000,000	neg	neg	neg	neg	neg	
USD 	1M	3M	6M	1Y	2Y	
≤199,999	0.05	0.10	0.15	0.20	0.25	
200,000-499,999	0.05	0.10	0.15	0.20	0.25	
500,000-999,999	0.05	0.15	0.20	0.25	0.30	
≥1,000,000	neg	neg	neg	neg	neg	
GBP 	1M	3M	6M	1Y	2Y	
≤49,999	0.05	0.15	0.20	0.25	0.50	
≥50,000	neg	neg	neg	neg	neg	
Llogari kursimi*/ Saving account* LEK						
 0.30						
EUR 	0.002					
USD	0.10					
GBP	0.10					
Note:						
1. For the savings account:*Interest is calculated on the minimum monthly balance. The interest will be credited every end of month. This account is offered only to Non-Governmental Organizations (NGO).						
2. Time Deposits.						
<ul style="list-style-type: none"> The Bank reserves the right to change the above rates at any time, without prior notification. PERIOD (Calc./Basis for time deposits 365/365). Frequency of interest payment for time deposits is at maturity date. 						

Shënim:

- Për llogaritë e kursimit: *Interesi llogaritet mbi balancën më të ulët të muajit. Interesi do t'ju kreditohet në fund të çdo muaji. Kjo llogari i ofrohet vetëm Organizatave Joqeveritare (OJQ)
- Depozitat me afat.
 - Banka rezervon të drejtën të ndryshojë normat e mësipërme, në çdo kohë pa paralajmërim.
 - PERIUDHA (Baza/Llogaritjes për depozitat me afat 365/365)
 - Frekuenca e pagesës së interesit për depozitat me afat është në datën e maturimit.

LIGJI PER SIGURIMIN E DEPOZITAVE

Agjencia e Sigurimit të Depozitave (Agjencia) është person juridik publik, me seli në Tiranë, e cila ushtron funksionet e saj me qëllim përmbushjen e objektivave në zbatim të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave” i ndryshuar.

“INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” SHA, në bazë të ligjit Nr. 8873, datë 29.03.2002 “Per Sigurimin e Depozitave” I ndryshuar në Ligjin Nr. 53/2014, datë 22.05.2014, është pajisur nga Agjencia me Certifikatën për Sigurimin e Depozitave Nr. 10 datë 11.05.2009.

Në bazë të kësaj Certifikate, Agjencia, sipas Nenit 33, paragrafi 1 pika a) të Ligjit Nr. 53/2014 datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave”, siguron dhe kompenson depozitat e sigurueshme të cdo depozituesi në Banken INTESA SANPAOLO BANKA ALBANIA SHA në masen 100 per qind, por në cdo rast jo më shume se 2,500,000 (dy million e peseqind mije) Lek, pavaresisht numrit të depozitave apo llojit të monedhes se tyre, të depozituara në këtë Bankë.

A – PERKUFIZIME

“**Certifikata e sigurimit të depozitave**”, bazuar në Nenin 3, paragrafi 8 të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave, është akti administrativ i lëshuar nga Agjencia, me anën e të cilit një person juridik bëhet anëtar i skemës së sigurimit të depozitave.

“**Depozitues**”, bazuar në Nenin 3, paragrafi 17 të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 për “Sigurimin e Depozitave” i ndryshuar, është cdo person fizik, tregtar dhe shoqëri tregtare, të cilët kanë të drejten e perfitimit të pageses së një depozite nga një subjekt anëtar i skemës së sigurimit të depozitave, përfshirë këtu titullarin me të drejta të plota të një depozite në bashkëpronësi dhe çdo përfitues të një depozite të palës së tretë.

“**Depozitë e sigurueshme**”, bazuar në Nenin 3, paragrafi 14 të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave” i ndryshuar, është vlera e agreguar e të gjitha depozitave të një depozituesi, përfshirë interesin e përlloragitur të tyre në ditën e vlerësimit ose të ndërhyrjes në një subjekt anëtar të skemës, përveç përjashtimeve të nenit 32 të këtij ligji.

“**Depozitë e siguruar në bankë dhe degë të saj**”, bazuar në Nenin 3, paragrafi 15 të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave” i ndryshuar, është pjesa e depozitës së sigurueshme e një depozituesi, i cili mbulohet me sigurim nga Agjencia.

“**Depozitat e pasigurueshme**”, bazuar në Nenin 32 të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave” i ndryshuar, janë depozitat e mëposhtme te cilat përjashtohen nga sigurimi dhe kompensimi nga Agjencia:

- 1) pjesa e depozitës në bankë ose degën e bankës së huaj me vlerë mbi 2,500,000 (dy milionë e pesëqind mijë) Lek ose shuma e barazvlefshme me të (kundërvlerën), në monedhë të huaj;
- 2) depozitat e bankës, degës së bankës, degës së bankës së huaj dhe shoqërisë së kursim-kreditit në emër dhe për llogari të vet, si dhe çdo subjekt tjetër financiar i licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
- 3) depozitat e drejtorit, administratorit në bankë dhe familjarëve të tyre, sipas çertifikatës së gjendjes familjare;
- 4) depozitat e çdo personi që zotëron 5 për qind ose më shumë në kapitalin e subjektit anëtar ose të aksioneve me të drejtë vote në këtë subjekt;

- 5) depozitat e prejardhura nga veprimtari të lidhura me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, të cilat janë deklaruar të paligjshme me vendim gjykatë të formës së prerë;
- 6) depozitat e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, vendase ose të huaja;
- 7) depozitat e subjekteve të sipërmarrjes ose investimeve kolektive, vendase ose të huaja;
- 8) depozitat e fondeve të pensionit ose sigurimit pensional, vendase ose të huaja;
- 9) tituj të emetuar nga subjekte financiare dhe çdolloj detyrimi tjetër që këto subjekte kanë bazuar mbi marrëveshjet e tyre të premtimit;
- 10) depozitat e njësive të pushtetit qendror ose vendor, si dhe çdo enti publik të Republikës së Shqipërisë ose të një vendi të huaj;
- 11) depozitat të paemëtuara dhe/ose titulli i të cilave nuk përcaktohet qartë;
- 12) depozitat e vendosura në subjektin anëtar të skemës së sigurimit të depozitave gjatë dhe pas ditës së ngjarjes së sigurimit në këtë subjekt;
- 13) depozitat e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë së kursim-kreditit, sipas përcaktimeve në ligjin për shoqëritë e kursim-kreditit, përveç asamblesë së përgjithshme;
- 14) depozitat e personave juridik, përveç atyre të përcaktuara në pikën 17, të nenit 3, të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave” i ndryshuar.

“**Shoqëri tregtare**”, bazuar në Nenin 3, paragrafi 34 të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave” i ndryshuar, ka kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe/ose çdo ligj ndryshues i tij.

“**Skema e sigurimit të depozitave**”, bazuar në Nenin 3, paragrafi 23 të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave” i ndryshuar, është marrëdhënia juridike dhe veprimtaria për sigurimin dhe kompensimin e depozitave, që krijohet ndërmjet subjekteve anëtare të skemës dhe institucioneve publike në përfitim të depozituesve.

“**Tregtar**”, bazuar në Nenin 3, paragrafi 33 të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave” i ndryshuar, ka kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe/ose çdo ligj ndryshues i tij.

B – SIGURIMI I DEPOZITAVE

1. Agjencia siguron depozitat e *individëve, tregtarëve dhe shoqërive tregtare* në bankat anëtare në skemë, bazuar në:
 - a) kontratën e depozitës;
 - b) dokumentet kontabël;
 - c) të dhënat e regjistrit elektronik.
2. Sigurimi i depozitës përfundon kur:
 - a) depozita klasifikohet si depozitë e pasiguruar,
 - b) depozita kompensohet nga Agjencia si pasojë e likuidimit të detyruar të bankës.

3. Në rastin e likuidimit vullnetar të bankës, depozitat mbeten të siguruara deri në përfundimin e këtij procesi.
4. Në rastet e riorganizimit juridik, depozitat e siguruara të bankave pjesëmarrëse mbeten të siguruara për çdonjërin prej tyre tre muaj pas datës në të cilën Agjencia njoftohet me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për përfundimin e procesit të transformimit
5. Bankat zbatojnë nenin 26 të Ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar nëpërmjet krijimit, mirëmbajtjes dhe funksionimit të sistemeve elektronike për mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave për vlerësimin e shumës së depozitave të siguruara në çdo kohë, sipas aneksit 11 “Vlerësimi i shumës së depozitave të siguruara” të saj.
6. Shuma e depozitave të siguruara është vlera aritmetike që shërben si bazë për përlllogaritjen e primit dhe që rezulton nga zbatimi i hapave të mëposhtëm:
 - a) mbajtja e saktë e të dhënave personale të depozituesit dhe për depozitat e këtij depozituesi;
 - b) mbajtja e një numri të vetëm (kodit personal në sistem) të depozituesit, me qëllim që ai të identifikohet në mënyrë të saktë dhe pa përsëritje;
 - c) zbatimin e përjashtimeve nga skema e sigurimit të depozitave;
 - d) përlllogaritjen e interesit përkatës të çdo depozite të depozituesit;
 - e) konvertimin e depozitave në valutë, në lekë, sipas kursit zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës;
 - f) zbatimin e kushteve kontraktore që zbatohen ndaj çdo depozite (sipas rasteve të përcaktuara në aneksin 11);
 - g) mbledhjen e të gjitha depozitave të depozituesit si një llogari depozitë e vetme.
 - h) krahasimi i vlerës së depozitës të vetme me 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

C – KOMPESIMI I DEPOZITAVE

Procedurat e kompensimit, sipas nenit 39, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave” i ndryshuar, fillojnë menjëherë në momentin kur Agjencia njoftohet me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për vendosjen e subjektit anëtar të skemës së sigurimit të depozitave në likuidim të detyruar. Kompensimi përfundon jo më vonë se tre muaj nga data e fillimit të tij. Agjencia, sipas nenit 33, paragrafi 1 pika a) të Ligjit Nr.53/2014 datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave” i ndryshuar, siguron dhe kompenson depozitat e sigurueshme të çdo depozituesi në bankë ose në degën e bankës së huaj në masën 100 për

qind, por në çdo rast jo më shumë se 2,500,000 (dy milionë e pesëqind mijë) Lek, pavarësisht numrit të depozitave apo llojit të monedhës të tyre, të depozituara në këtë bankë.

D – TERMAT DHE KUSHTET PER PAGESEN E KOMPESIMIT

Niveli maksimal i kompensimit për çdo depozitues, sipas nenit 38, paragrafi 2 të ligjit Nr.53/2014 datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave” i ndryshuar, përlllogaritet sipas përcaktimeve të nenit 33 të këtij Ligji, duke zbritur shumën e detyrimeve të papaguara në kohë të depozituesit ndaj subjektit anëtar, që rezulton në vonesë shlyerjeje në ditën e ndërhyrjes nga Autoriteti Mbikëqyrës. Agjencia, bazuar në nenin 38, paragrafi 12 të Ligjit Nr. 53/2014 datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave”, ka të drejtë të refuzojë kompensimin ose të kërkojë kthimin e kompensimit për depozitat e siguruara, kur e drejta për kompensim bazohet në të dhëna të pavërteta dhe mashtruese dhe kur vëren se nuk ka interes të sigurueshëm. Interes i sigurueshëm është interesi i ligjshëm dhe nevoja objektive e depozituesit për t’u mbrojtur nga humbja financiare e depozitave në një ngjarje sigurimi.

Agjencia, sipas nenit 39, paragrafi 4 të Ligjit Nr.53/2014 datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave”, mund të kompensojë depozitën e siguruar nëpërmjet njëres prej këtyre mënyrave:

- 1) pagesës së shumës në Lek personit në ambientet e subjektit të vendosur në likuidim në bashkëpunim me likuidatorin;
- 2) pagesës së shumës në Lek personit në ambientet e një banke anëtare të skemës (banka agjente);
- 3) transfertës së shuës që përfitohet nga depozituesi në një bankë anëtare të skemës së sigurimit të depozitave;
- 4) pagesës me çek;
- 5) mënyra të tjera pagese të miratuara me akt nënligjor të Autoritetit Mbikëqyrës.

Shënim: Ky informacion jepet në zbatim të detyrimit për informimin e publikut nga subjektet anëtare të skemës në baze të nenit 27 të Ligjit Nr. 53/2014 datë 22.05.2014 “Për Sigurimin e Depozitave”.